

 Republika e Kosovës Republika Kosovo	ZYRA E PERSONELIT KANCELARIJA OSOBLJA		 Komuna e Istogut Opština Istok
	02 Nr.456/12	Data: 02.10.2012	

Udhëheqësi i Personelit, në bazë të nenit 11.alineja 1. të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.72/2010) dhe nenit 15 të Rregullores mbi rekrutimin Nr.02/10, s h p a l l :

K O N K U R S

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në Organet Komunale të Administratës dhe atë:

I. NË DREJTORATIN PËR ADMINISTRATË KOMUNALE

Titulli i vendit të punës: Zyrtar i Gjendjes Civile

Nr. I ref. 02 nr.456/12

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Pranon kërkesa dhe lëshon çertifikata të lindjes, vdekjes dhe të martesave;
- Bënë regjistrimet e rregullta në librinë amëz të lindjeve, martesave dhe vdekjes si dhe regjistrimin e mëvonshëm në LAL,LAM dhe LAV;
- Pranon kërkesa, merr në pyetje dëshmitarët, lëshon çertifikata të statusit martesor për zyrtar të vendit përkatës ku punon ;
- Lëshon çertifikata të statusit jetësor dhe statusit martesorë;
- Lëshon vërtetima nga LAL, LAM dhe LAV;
- Lëshon deklarata të bashkësisë familjare;
- Si dhe punët të tjera të parashtruara nga eprori.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

Të drejtë për punësim kanë të gjithë personat e moshës madhore të cilet kanë zotësi për të vepruar, janë në posedim të drejtave civile dhe politike , kanë përgaditjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë e duhur për kryerjen e detyrave të punës.

Procedura e konkurimit:

Procedura e konkurimit është e hapur për kandidatët e jashtëm si dhe nëpunësit civil eksistues.

Shkollimi i kërkuar:

- ☐ Përgaditja - bachelor

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera:

- ☐ Përvoja e punës e dëshirueshme;
- ☐ Njohja e punës me kompjuter (Word,Excel) e domosdoshme .
- ☐ Të ketë aftësi komunikimi, të jetë transparent dhe spjegim të çështjeve konkrete nga lamia e gjendjes civile.

Kohëzgjatja e emrimit:

Emrimi është në kohë të pacaktuar.

Koeficienti: 6

Dokumentet e nevojshme: Dëshmi të kualifikimeve shkollore; Dëshmi mbi përvojën e punës ; Dy letër rekomandime; Dokument identifikimi; Çertifikata e lindjes dhe Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlersimit (të punësuarit).

Afati i konkursit;

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit .

“Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinis mashkullore dhe femrore nga të gjitha komunitetet në Kosovë “.

Kandidatët e interesuar mund t’i marrin formularët e kërkesave, çdo ditë pune në Zyrën nr. 4, (tek Udhëheqësi i Personelit), në ndërtesën e Komunës së Istogut, ku edhe mund të dorzohen.Për informata mund të kontaktoni me nr. tel. 044/223-928.

Vërejtje: Dokumentat e pakompletuara, si dhe parashtrimi i kërkesave pas skadimit të afatit të përcaktuar, nuk do të shqyrtohen.

Udhëheqësi i Personelit
Fatmir Bytyçi